



TË DREJTAT E PACIENTËVE KRYESORET

Duke qenë i informuar mirë për të drejtat e tij, pacienti mund të marrë pjesë në trajtimin që i propozohet dhe të ndërtojë marrëdhënie cilësore me profesionistët e shëndetit.

1. E DREJTA E INFORMIMIT

Pacienti ka të drejtën për t'u informuar në mënyrë të qartë dhe të duhur mbi gjendjen e tij shëndetsore, mbi kontrollet dhe trajtimet e mundshme, mbi pasojat dhe rreziqet eventuale që paraqesin ato, mbi pronostikun dhe aspektet financiare të trajtimit. Në momentin e pranimit të tij në një institucion shëndetsor, pacienti merr në parim një informacion të shkruar mbi të drejtat dhe detyrat e tij si dhe kushtet e qëndrimit të tij atje.

2. PRANIM I LIRË E I VETËDIJSHËM

Asnjë kurë nuk mund të jepet pa pranimin e lirë e të vetëdijshëm prej një pacienti të aftë për të kuptuar, qoftë ai i rritur apo i mitur. Në fakt, pacienti ka të drejtën ta refuzojë kurën, ta ndërpresë trajtimin apo të largohet nga institucioni shëndetsor në se dëshiron.

3. DIREKTIVA PARAPRIËSE, PËRFAQËSUES TERAPEUTIK DHE MANDAT PËR SHKAK PAAFTËSIE

Cilido ka të drejtën të formulojë direktiva paraprirëse për të përcaktuar tipin e kurave që do të donte të merrte apo jo, në rast se nuk do të ishte më në gjendje të shprehte vullnetin e tij. Ai mund gjithashtu të caktojë dikë, një përfaqësues terapeutik, të ngarkuar të prononcohet në vend të tij për zgjedhjen e kurave që duhet t'i jepen në situatat kur ai nuk do të mundte të shprehej.

4. E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR LIRSHËM

Në rast trajtimi ambulator, pacienti ka të drejtën të zgjedhë lirshëm punonjësën shëndetsore të cilit dëshiron t'i drejtohet. Në parim, ai ka edhe të drejtën për të zgjedhur lirshëm institucionin shëndetsor publik apo të njohur si me interes publik ku dëshiron të kurohet. Zgjedhja e lirë e profesionistit apo institucionit shëndetsor mund të kufizohet indirekt prej marrjes përsipër prej sigurimit shëndetsor bazë, që mund të jetë i pjesshëm pikërisht për trajtimet spitalore jashtë kantonit.

5. MASA MBAJTËSE DHE TRAJTIME PA PRANIM

Si parim, çdo masë mbajtëse ndaj pacientëve është e ndaluar. Kështu është edhe për trajtimet pa pranimin e tyre. Masa që kufizojnë lirinë e lëvizjes apo trajtime pa pranim edhe mund të imponohen, por me kushte shumë strikte.

6. SEKRETI PROFESIONAL

Pacienti ka të drejtën e respektimit të konfidencialitetit të të dhënave që kanë të bëjnë me të. Profesionistët e shëndetit kanë detyrimin të respektojnë sekretin profesional, që quhet edhe sekret mjeksor. Ata duhet t'i ruajnë për veten e tyre informacionet për të cilat kanë dijeni gjatë praktikimit të profesionit të tyre. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, ata nuk mund t'i transmetojnë ato pa pëlqimin e pacientit të tyre. Sekretin profesional zbatohet edhe midis profesionistëve të shëndetit.

7. QASJA NË DOSJE

Pacienti ka të drejtën të konsultojë dosjen e vet dhe të kërkojë që t'ia shpjegojnë kuptimin. Ai mund të marrë në parim falas dokumentet origjinale apo kopje të tyre, dhe mund t'ua transmetojë profesionistëve të shëndetit të zgjedhur prej tij.

8. E DREJTA PËR T'U SHOQËRUAR

Një pacient që qëndron në një institucion shëndetsor ka të drejtën për ndihmë dhe këshilla gjatë gjithë kohës të qëndrimit. Ai ka të drejtën të kërkojë mbështetjen e të afërmve dhe të mbajë kontakt me rrethin e vet. Në se dëshiron, ai mund të kërkojë edhe një shoqërues të jashtëm.

9. DHURIM ORGANESH DHE INDESH

Një person mund të vendosë për së gjalli të japë organet e veta për qëllime transplantimi. Vullneti i personit të vdekur ka përparësi ndaj atij të të afërmve të tij. Dhurimi i organeve, indeve apo qelizave është falas, ndalohet bërja e tregtisë me to.

A KENI NEVOJË PËR NDIHMË, INFORMACIONE APO KËSHILLA?

**kërkoni broshurën e plotë «Kryesorja mbi të drejtat e pacientëve»
ose kontaktoni autoritetet sanitare të kantonit tuaj:**

Kantoni i Bernës

Direction de la santé publique
et de la prévoyance sociale
Rathausgasse 1, 3011 Berne
Tél. 031 633 79 20
info@gef.be.ch
www.gef.be.ch

Kantoni i Friburgut

Service de la santé publique
Rte des Cliniques 17, 1700 Fribourg
Tél. 026 305 29 13
ssp@fr.ch
www.fr.ch/ssp

Republika dhe Kanton i Gjenevës

Direction générale de la santé
Service du médecin cantonal
Av. de Beau-Séjour 24,
Case postale 76,
1211 Genève 4 Plainpalais
Tél. 022 546 50 00
www.ge.ch/deas

Kanton Graubünden

Gesundheitsamt
Planaterrastrasse 16, 7001 Chur
Tel. 081 257 26 44
info@san.gr.ch
www.gesundheitsamt.gr.ch

Republika dhe Kanton i Zhyrasë

Service de la santé publique
Médecin cantonal
Fbg des Capucins 20,
2800 Delémont
Tél. 032 420 51 33
medecin.cantonal@jura.ch

Kantoni i Njushatelit

Service de la santé publique (DFS)
Rue Pourtalès 2, 2000 Neuchâtel
Tél. 032 889 52 09
www.ne.ch/santepublique

Republika dhe Kanton i Tiçinos

Dipartimento della sanità
e della socialità
Ufficio Medico cantonale
Via Dogana 16, 6500 Bellinzona
Tél. 091 814 30 50
dss-umc@ti.ch
www.ti.ch/promozionesalute

Kantoni i Valesë


Service de la santé publique
Office du médecin cantonal
Av. du Midi 7, 1950 Sion
Tél. 027 606 49 00
santepublique@admin.vs.ch
www.vs.ch/sante

Kantoni i Vaudit

Service de la santé publique
Bâtiment administratif de la Pontaise
Avenue des Casernes 2,
1014 Lausanne
Tél. 021 316 42 00
info.santepublique@vd.ch
www.vd.ch/ssp

Kanton Basel-Stadt

Gesundheitsdepartement
Bereich Gesundheitsversorgung
Gerbergasse 13, Postfach 564,
4001 Basel
Tel. 061 205 32 42
gesundheitsversorgung@bs.ch
www.gesundheitsversorgung.bs.ch



 Kanton Graubünden
Chantun Grischun
Cantone dei Grigioni



Kanton Basel-Stadt



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FRIEBURG
Direction de la santé et des affaires sociales DSAS
Direktion für Gesundheit und Soziales GSD



REPUBLIQUE
ET CANTON
DE GENÈVE

JURA **CH**
REPUBLIQUE ET CANTON DU JURA

ine.ch
REPUBLIQUE ET CANTON DE NEUCHÂTEL



Repubblica e Cantone
Ticino

CANTON DU VALAIS
KANTON WALLIS